



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 22/2008

Më 28.10.2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Ethem Çeku, Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Sala Berisha – Shala dhe Berim Ramosaj.

Munguan: Myzejene Selmani, Slobodan Petroviq, Safete Hadergjonaj dhe Múfera Şinik.

Të pranishëm: Remzije Hajdari – Departamenti Ligjor në MTI, Bedri Millaku - Departamenti i Turizmit në MTI, Blerina Uka nga NDI dhe Valon Hyseni nga KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina;

Mbledhjen e drejtoi: Ethem Çeku – zv.kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 tetor 2008;
3. Ligji Nr.02/L- 135 për Ndryshimin dhe Plotësimin të Ligjit për rrugët nr. 2003/11 (sipas Vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të dt. 20 korrik 2008);
4. Ligji Nr.02/L-027, për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas Vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të dt. 20 korrik 2008);
5. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 tetor 2008;

Procesverbali i mbledhjes së datës 14 tetor 2008, u miratua pa vërejtje.

III. Ligji Nr.02/L-135 për Ndryshimin dhe Plotësimin të Ligjit për rrugët nr. 2003/11 (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);

Ethem Çeku – ia dha fjalën znj.Jashari, për prezentimin e amendamenteve të Grupit punues për këtë ligj.

Kaqusha Jashari – prezantoi amendamentet e Grupit punues, të cilat i dorëzojë edhe më shkrim, dhe njiherit kërkoj nga Komisioni për miratim.

Pas diskutimeve të gjera nga deputetet Zef Morina, Fatmir Rexhepi, Haki Shatri dhe Berim Ramosaj, Komisioni unanimitisht nxori këtë:

Përfundim

- a) Miratohen amendamentet e Grupit punues për Ligjin Nr.02L-135, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11 (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);
- b) Autorizohet Njësia mbështetëse e Komisionit për përpilimin e Raportit më Rekomadime, për seancë plenare;

IV.Ligji Nr.02/L-027, për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas Vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të dt. 20 korrik 2008);

Ethem Çeku – ia dha fjalën z.Shatri, për prezentimin e amendamenteve të Grupit punues për këtë ligj.

Haki Shatri – i paraqiti amendamentet e Grupit punues, të cilat i dorëzojë edhe më shkrim, dhe njiherit kërkoj nga Komisioni për miratim.

Pas diskutimeve të gjera deputet Sala Berisha – Shala dhe Fatmir Rexhepi, Komisioni unanimitisht e nxori këtë:

Përfundim

- a) Miratohen amendamentet e Grupit punues për Ligjin Nr.02/L-027, për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas Vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të dt. 20 korrik 2008);
- b) Autorizohet Njësia mbështetëse e Komisionit për përpilimin e Raportit më Rekomadime, për seancë plenare;

V. Të ndryshme;

Ethem Çeku – i njoftoi anëtarët e Komisionit, që kanë ardhur dy kërkesa për shqyrtim, si: Vendimi i Qeverisë nr.03/38, datë 2 tetor 2008, për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit të furnizimit të KEK-ut, dhe Planifikimi Buxhetor i KPMM-së për vitin 2009-2011.

Pas diskutimit të gjera Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- a) Këto kërkesa të jenë objekt shqyrtimi apo rend i ditës, së mbledhjes e radhës të Komisionit;
- b) Të kërkohet nga të dy institucionet e lartëpërmendura që të dërgojnë dokumentacion shtesë, për qëllim informimi sa më të gjerë të Komisionit;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Zv.kryetar i Komisionit

Ethem Çeku